



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 573/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Vushtri, paraqitur kundër Keshillave të Vendvotimit (KVV) në Komunën e Vushtrris për shkak të manipulimit të votave, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Vushtri: Anr.573 /2013, Anr.574/2013, Anr.575/2013, Anr.576/2013, Anr.577/2013, Anr.578/2013, Anr.579/2013, Anr.580/2013.

Arsyetim

PZAP, më datë 04.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr.573/2013, Anr.574/2013, Anr.575/2013, Anr.576/2013, Anr.577/2013, Anr.578/2013, Anr.579/2013 dhe Anr.580/2013, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), me seli në Vushtri, me të cilat pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjatë procesit të numrimit gjatë ditës së votimit, në Zgjedhjet lokale të 3 Nëntorit 2013.

- Në ankesën Anr.573/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjatë procesit të numrimit të votave nga anëtarët e keshillit të vendvotimit të qendres së votimit 2723B të evidentuara nga Xhevahire Selmanie kandidatë për asamble komunale nga rradhjet e subjektit politik PDK-se ku me atë rast numri i votave në kutinë e votimit nuk ishte identik me numrin e votave të prezentuar në procesverbal.
- Në ankesën Anr.574/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjatë procesit të numrimit të votave nga anëtarët e keshillit të vendvotimit në qendrën e vendvotimit 2703B të evidentuara nga Xhevahire Selmani kandidatë për asamble komunale nga rradhjet e subjektit politik PDK-se ku

me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te prezantuara ne procesverbal.

- Në ankesën Anr.575/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procesit e numrimit nga anetaret e kshillit te votimit ne qendren e votimit 2707B te evidentuara nga Xhevahire Selmani kandidate per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te przentuara ne procesverbal.
- Në ankesën Anr.576/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procesit te numrimit nga anetaret kshillit te votimit ne qendren e votimit 2703B te evidentuara nga Sami Istrefi kandidat per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te prezantuara ne procesverbal.
- Në ankesën Anr.577/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procesit te numrimit nga anetaret e kshillit te votimit ne qendren e votimit 2717B te evidentuara nga Sami Istrefi kandidat per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te prezantuara ne procesverbal.
- Në ankesën Anr.578/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procesit te numrimit nga anetaret e kshillit te votimit ne qendren e votimit 2723B te evidentuara nga Sami Istrefi kandidat per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te prezantuara ne procesverbal.
- Në ankesën Anr.579/201, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procsit te numrimit nga anetaret e kshillit te votimit ne qendren e votimit 2709B te evidentuara nga Sami Istrefi kandidat per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrin e votave te prezantuara ne procesverbal.
- Si dhe në ankesën Anr.580/2013, pretendohet se ka ndodhur manipulim i votave gjate procesit te numrimit nga anetaret e kshillit te votimit ne qendren e votimit 2707b te evidentuara nga Sami Istrefi kandidat per asamble komunale nga rradhet e subjektit politik PDK-se ku me ate rast numri i votave ne kutine e votimit nuk ishte identik me numrine votave te prezantuara ne procesverbal.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i në bazë të nenit 117.2 te Ligjit Nr. 03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LZP-së ka shqyrtuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre dhe të provave tjera që

gjenden në shkresa të lendes, duke konsideruar se nuk është e nevojshme caktimi i seancës dëgjimore ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara.

Pretendimet ankimore nga ana e kandidateve të subjektit politik PDK-se për asamble komunale, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesa, lidhur me manipulimin e votave në Qendrat e Votimit 2723B, 2703B, 2707B, 2717B, 2709B, janë të pabazuara, nga shkaku se nga parashtruesit e ankesave nuk është bashkangjitur asnjë provë shtese ankesave të parashtruara, me të cilat do të mund të administroheshin lëndët, ose do të mund të verifikoheshin vërtetësia e shkeljes së pretenduar.

Andaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se ka ndodhur manipulim i votave nga anëtarët e këshillit të votimit, PZAP-i në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesat e lart përmendura u refuzuan si të pa bazuara. Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 573 /2013 më datën 06.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*